

**KOMBET E  
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen  
Penale të Personave Përgjegjës për  
Shkelje të Rënda të së Drejtës  
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera  
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej  
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84-R77.4

Data: 29 maj 2008

Originali: anglisht

**NË DHOMËN GJYQËSORE I**

**Para:** Gjykatësit Alphons Orië, Kryegjykatës  
Gjykatëses Christine Van Den Wyngaert  
Gjykatësit Bakone Justice Moloto

**Sekretari:** Z. Hans Holthuis

**Vendim i datës:** 29 maj 2008

**PROKURORI**

**kundër**

**ASTRIT HARAQISË  
dhe  
BAJRUSH MORINËS**

*PUBLIK*

**VENDIM NË LIDHJE ME KËRKESAT E HARAQISË DHE MORINËS  
PËR RISHQYRTIMIN E URDHËRESËS PËR CAKTIMIN E DATËS  
DHE PËR LEJË PËR APEL**

**Zyrës së Prokurorit:**

Z. Serge Brammertz  
Z. David Re  
Z. Stefan Wäspi

**Avokatëve të të Akuzuarve:**

Z. Karim A.A. Khan për Astrit Haraqinë  
Z. Jens Dieckman për Bajrush Morinën

**DHOMA GJYQËSORE I** (“Dhoma Gjyqësore”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare Të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”);

**PASI ËSHTË INFORMUAR** për “Kërkesën e Astrir Haraqisë për Rishqyrtimin e Urdhëresës për Caktimin e Datës së Nisjes së Procesit Gjyqësor të 20 majit 2008” dorëzuar publikisht me shtojca konfidenciale A-D më 26 maj 2008, dhe bashkimin me këtë kërkesë prej Bajrush Morinës,<sup>1</sup> (që përmenden bashkërisht si “Mocioni i Rishqyrtimit”) ku Mbrojtja kërkon që Dhoma Gjyqësore (i) të rishqyrtojë “Urdhëresën për Caktimin e Datës së Nisjes së Procesit Gjyqësor” lëshuar prej Gjykatësit Paragjyqësor më 20 maj 2008 (“Urdhëresë për Caktim Date”), (ii) të lejojë palët të dorëzojnë parashtrime në lidhje me nisjen e procesit gjyqësor dhe (iii) të caktojë si datë të nisjes së procesit gjyqësor një datë pas pushimeve verore të gjykatës;<sup>2</sup>

**PASI ËSHTË INFORMUAR GJITHASHTU** për “Kërkesën e Astrit Haraqisë për Lejë për Apelimin e Urdhëresës për Caktimin e Datës së Nisjes së Procesit Gjyqësor të 20 majit 2008” dorëzuar publikisht me shtojcat konfidenciale A-D më 26 maj 2008 dhe bashkimin me këtë kërkesë prej Bajrush Morinës,<sup>3</sup> (që së bashku përmenden si “Kërkesa për Lejë”), ku Mbrojtja kërkon lejë për apelimin e Urdhëresës për Caktim Date;

**DUKE MARRË SHËNIM** se Dhoma Gjyqësore ka kompetencë të vetvetishme për rishqyrtimin e një vendimi të mëparshëm në rast të një arsytimi qartësisht të gabuar ose në rast të ekzistencës së rrethanave të veçanta që përligjin rishqyrtimin për parandalimin e një padrejtësie,<sup>4</sup> dhe se rrethana të tilla mund të përfshijnë fakte ose argumente të rinj që kanë dalë që prej lëshimit të vendimit;<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Bajrush Morina’s Joinder in “Astrir Haraqija’s Request for Reconsideration of the Scheduling Order Regarding Commencement of Trial dated 20 May 2008 with Confidential Annexes A-D”, 27 May 2008; Kërkesa e Bajrush Morinës për Bashkim me “Kërkesën e Astrir Haraqisë për Rishqyrtimin e Urdhëresës për Caktimin e Datës së Nisjes së Procesit Gjyqësor të 20 majit 2008 me Shtojcat Konfidenciale A-D”, 27 maj 2008.

<sup>2</sup> Reconsideration Motion/Mocioni i Rishqyrtimit, paragrafi 20.

<sup>3</sup> Bajrush Morina’s Joinder in “Astrir Haraqija’s Request for Certification for Appeal of Trial Chamber’s Scheduling Order Regarding Commencement of Trial Dated 20 May 2008 with Confidential Annexes A-D”, 27 May 2008; Kërkesa e Bajrush Morinës për Bashkim me “Kërkesën e Astrir Haraqisë për Lejë për Apelimin e Urdhëresës së Dhomës Gjyqësore për Caktimin e Datës së Nisjes së Procesit Gjyqësor të 20 majit 2008 me Shtojcat Konfidenciale A-D”, 27 maj 2008.

<sup>4</sup> See *Prosecutor v. Slobodan Milošević/Prokurori kundër Slobodan Millosheviqit*, Case No/Lënda Nr.. IT-02-54-AR108bis.3. Confidential Decision on Request of Serbia and Montenegro for Review of the Trial Chamber’s Decision of 6 december 2005, 6 April 2006, para 25, fn 40/Vendim Konfidencial në lidhje me kërkesën e Serbisë dhe Malit të Zi për Shqyrtimin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore të 6 dhjetorit 2005, 6 prill 2006, paragrafi 25, poshtëshënimi 40.

<sup>5</sup> See *Prosecutor v. Rasim Delić/Prokurori kundër Rasim Deliqit*, Case No/Lënda Nr.. IT-04-83-T, Decision on the Prosecution’s Motion for Reconsideration of the Chamber’s Decision on Admission of Documentary Evidence, 13 February 2008, para 9/Vendim në lidhje me Mocionin e Prokurorisë për Rishqyrtimin e Vendimit të Dhomës për Pranimin e Provave Dokumentare, 13 shkurt 2008, paragrafi 9; *Prosecutor v. Prlić et al/Prokurori kundër Përlitit dhe të tjerëve*, Case No/Lënda Nr.. IT-04-74-T, Second Decision on the Admission of Documentary Evidence, submitted by the Prosecution (Dretclj and Gabela) 12 December 2007, p.4, fn.4 with further references/Vendim i Dytë në lidhje me Pranimin e Provave Dokumentare paraqitur prej Prokurorisë, 12 dhjetor 2007, p.4, psh.4 me referenca të mëtejshme.

**DUKE MARRË PARASYSH** se shqetësimet e ngritura prej Mbrojtjes në Mocionin e Rishqyrtimit cekin çështjen e të drejtës së të akuzuarve për kohë të mjaftueshme në përgatitjen e mbrojtjes;<sup>6</sup>

**DUKE KONKLUDUAR** se bazuar në argumentet dhe rrethanat e ngritura prej Mbrojtjes, Dhoma Gjyqësore e gjykon të përshtatshme të rishqyrtojë datat e nisjes së gjykimit dhe datat për dorëzimin e Dosjes Paragjyqësore të Mbrojtjes dhe listave të dëshmitarëve 65ter të Mbrojtjes dhe të provave materiale;

**DUKE GJYKUAR** se rrjedhimisht Kërkesa për Lejë është e panevojshme;

**BAZUAR** në Rregullat 54 dhe 65ter të Rregullores

**MIRATON** Mocionin e Rishqyrtimit; dhe

**URDHËRON** si më poshtë:

1. Të shfuqizohet Urdhëresa për Caktimin e Datës së Nisjes së Procesit Gjyqësor e 20 majit 2008;
2. Prokuroria të dorëzojë jo më vonë se 21 korrik 2008:
  - a. dosjen paragjyqësore, ku të përfshihet një përmbledhje e provave që Prokuroria synon të paraqesë në lidhje me kryerjen e krimit të pretenduar dhe formën e përgjegjësisë së mbartur prej të akuzuarve. Kjo dosje e cila nuk do të jetë më shumë se 5000 fjalë, të përfshijë çfarëdo pranimi prej palëve dhe një deklaratë të çështjeve që nuk kundërshtohen si dhe një deklaratë të çështjeve të kundërshtuara ligjore dhe faktuale;
  - b. listën e dëshmitarëve të cilët synon të ftojë Prokuroria. Kjo listë të përfshijë emrin ose pseudonimin e çdo dëshmitari, një përmbledhje të fakteve për të cilat do të dëshmojë çdo dëshmitar, pikat e Aktakuzës në lidhje me të cilat do të dëshmojë çdo dëshmitar, numrin e gjithsejtë të dëshmitarëve, të bëhet e ditur nëse dëshmitari do të

---

<sup>6</sup> Mocioni i Rishqyrtimit, paragrafët 3, 16-19.

dëshmojë duke qenë i pranishëm apo sipas Rregullave 92bis, 92ter ose 92quater, një vlerësim për kohëzgjatjen e nevojshme për çdo dëshmitar dhe vlerësim për kohëzgjatjen e procedimit të çështjes prej Prokurorisë;

c. listën e provave që Prokuroria synon të paraqesë

3. Mbrojtja të dorëzojë jo më vonë se 11 gusht 2008:

a. dosjen paragjyqësore me jo më shumë se 5000 fjalë ku trajtohen çështjet faktuale dhe ligjore dhe përfshihet një deklaratë me shkrim që përcakton në përgjithësi pikat e mbrojtjes së të Akuzuarve, çështjet në Dosjen Paragjyqësore të Prokurorisë për të cilat të Akuzuarit kanë kundërshtime dhe arsyet e kundërshtimit të të Akuzuarve në lidhje me çdo pikë të tillë;

b. listën e dëshmitarëve të cilët synon të ftojë Mbrojtja. Kjo listë të përfshijë emrin ose pseudonimin e çdo dëshmitari, një përmbledhje të fakteve për të cilat do të dëshmojë çdo dëshmitar, pikat e Aktakuzës në lidhje me të cilat do të dëshmojë çdo dëshmitar, numrin e gjithsejtë të dëshmitarëve, të bëhet e ditur nëse dëshmitari do të dëshmojë personalisht apo sipas Rregullave 92bis, 92ter ose 92quater, një vlerësim për kohëzgjatjen e nevojshme për çdo dëshmitar dhe vlerësim për kohëzgjatjen e procedimit të çështjes prej Prokurorisë;

c. listën e provave materiale që synon të paraqesë Mbrojtja;

4. Procesi gjyqësor të zhvillohet në periudhën 8-12 shtator 2008, në një kohë dhe vend që do të bëhen të njohura në kohën e duhur.

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/  
Gjykatësi Alphons Orië  
Kryegjykatës

Sot, më datën 29 maj 2008  
Në Hagë  
Holandë

**[Vula e Tribunalit]**